

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SHKENCES

**KABINETI**

Rruga e Durrësit, Nr. 23, Tiranë

Tel. 226307 Fax. 232002

Nr.4758 prot.

**U R D H Ë R**

**Nr. 233, datë 18. 07. 2005**

**PËR KONKURSET E PRANIMEVE TË REJA NË SHKOLLAT E MESME  
TË GJUHËVE TË HUAJA, ARTISTIKE, SPORTIVE,  
TEKNIKE DHE PROFESIONALE**

Në bazë të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Nenit 28 Pika 2 të Ligjit Nr. 7952, datë 21.06.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", Nenit 14 të "Dispozitave Normative Për Arsimin Parauniversitar",

**URDHËROJ:**

- 1.** Për shkollat e mesme, ku pranimet bëhen me konkurs, në vitin shkollor 2005-2006, të zbatohet "Rregullorja për pranimit e reja me konkurs në shkollat e mesme social-kulturore dhe teknike", Nr.5106 prot, datë 30.07.2004.
- 2.** Në shkollat e mesme **të gjuhëve të huaja dhe seksionet dygjuhëshe** konkurset të zhvillohen përkatësisht:

*në gjuhën angleze dhe frënge, me datë 30 gusht, për degët Anglisht dhe Frëngjisht.*

në gjuhën shqipe, me datë 31 gusht, për gjithë degët e tjera (Gjermanisht, Italisht, Spanjisht, Rusisht ) si dhe për të gjithë ata nxënës, që nuk kanë zhvilluar gjuhë të huaja në shkollën 8-vjeçare.

**Për shkollat e mesme të gjuhëve të huaja**, testi i konkurimit të ketë 30% të pyetjeve të përgjithshme dhe 70% të pyetjeve të karakterit gjuhësor. Testi i përgjithshëm të përmbajë pyetje nga lëndët: letërsi, matematikë, fizikë, histori dhe gjeografi kombëtare. Në testin e përgjithshëm, të mos përfshihen pyetje nga lëndët që janë të përfshira në testin e specialitetit.

**Për seksionet dygjuhëshe** në Tiranë, Korçë dhe Shkodër, testi i konkurimit të ketë 50 % të pyetjeve të përgjithshme dhe 50% të pyetjeve karakterit gjuhësor dhe të përmbajë pyetje nga po ato lëndë si dhe testi për shkollat e mesme të gjuhëve të huaja.

Në shkollat e mesme të gjuhëve të huaja dhe seksionet dygjuhëshe testi i përgjithshëm dhe special të përgatitet, nga QKAVP.

**3.** Në shkollat e mesme **artistike**, konkurimi të zhvillohet vetëm në fushat e specialitetit. Konkurimi të fillojë me datë 29 gusht dhe të vazhdojë jo më shumë se një javë, sipas programeve të hartuara nga drejtoritë e shkollave përkatëse.

Për realizimin e konkurseve në këto shkolla të vepohet në përputhje me shkresën Nr. 5119/2 Prot., datë 02.08.2004 të DZHK në MASH.

**4.** Në shkollën e mesme të **futbollit** “L. Boriçi”, në Tiranë dhe në shkollën e mesme **sportive** “B. Qeraxhia”, në Durrës, konkurimi të zhvillohet vetëm në fushat e specialitetit. Ai të fillojë me datë 29 gusht, dhe të vazhdojë jo më shumë se një javë, sipas programeve të hartuara nga drejtoritë e shkollave përkatëse.

Për realizimin e konkurseve në këto shkolla të vepohet në përputhje me shkresën Nr. 5119/1 Prot., datë 02.08.2004 të DZHK në MASH.

**5.** Në shkollën e mesme **teknike Hoteleri–Turizëm**, në Tiranë, për degën 5-vjeçare Hoteleri -Turizëm, konkursi të zhvillohet me 1 shtator. Testi të përmbajë matematikë, gjuhë shqipe, histori dhe gjeografi kombëtare. Ai të përgatitet nga QKAVP.

**6.** Në shkollën e mesme **teknike Ekonomike**, në Tiranë, konkursi të zhvillohet më 1 shtator. Testi të përmbajë matematikë dhe të përgatitet nga QKAVP.

**7.** Në shkollat e mesme **teknike**: “Arben Broci”, në Shkodër dhe “Pavarësia” në Vlorë, për degët 5- vjeçare, konkursi të zhvillohet më 1 shtator. Testi të përmbajë matematikë, fizikë, kimi dhe të përgatitet nga DAR përkatëse në bashkëpunim me drejtoritë e shkollave.

**8.** Në shkollën **profesionale** “Beqir Çela”, në Durrës për degët 3 - vjeçare Autoagromekanikë, Elektromekanikë dhe Instalues hidrosanitarë, konkursi të zhvillohet më 1 shtator. Testi të përmbajë pyetje nga matematika e fizika dhe të

përgatitet nga DAR përkatëse në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës.

**9.** Të gjitha konkurimet të monitorohen nga DAR përkatëse si dhe nga MASH.

**10.** Ngarkohen, për zbatimin e këtij Urdhëri, Drejtoria e Zhvillimit të Kurrikulës, QKAVP dhe DAR përkatëse.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI